

## KONTRATË SHITJEBLERJE KUOTASH

Sot në Tiranë, më datë 30/10/2018, u paraqitën palët e mëposhtme:

- **Z. Redjan Basha**, shtetas shqiptar, i biri i Nylbiut, lindur në Gjirokastër më 08.03.1984 dhe banues në Tiranë, mbajtës i kartës së identitetit me nr. personal I40308092C, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar, zotëruesh e një (1) kuote që përbën 10% (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë Abkons Sh.p.k me NUIS K61926012O (këtej e tutje referuar si "Shitësi");

nga njëra anë

dhe

- **Shoqëria Basha Capital Group Sh.p.k**, shoqëri e së drejtës shqiptare, e pajisur me NUIS L41924002T dhe me adresë veprimtarie në Njësia nr.2, Rruga Themistokli Gërmenji, pranë RTSH, kati II, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga administratori, Znj. Rabie Xhuveli (këtej e tutje referuar si "Blerësi").

nga ana tjetër

(këtej e tutje Shitësi dhe Blerësit referohen bashkarisht edhe si "Palët" dhe veçmas si "Pala")

### Kushtet paraprake

- A) Z. Redjan Basha (*Shitësi*) është ortak në shoqërinë Abkons Sh.p.k e pajisur me NUIS K61926012O. Sipas kapitalit aktual të shoqërisë, Shitësi zotëron 1 (një) kuotë të barabartë me 10% (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë Abkons Sh.p.k e pajisur me NUIS K61926012O (*këtej e tutje referua si Shoqëria*).
- B) Blerësi dëshiron të blejë nga Shitësi dhe Shitësi dëshiron të shesë kuotën e kapitalit që Shitësi disponon dhe zotëron në Shoqëri, të barabartë me vlerën nominale prej 10.000 Lekësh.

Meqë ekzistojnë kushtet paraprake, Palët pranojnë të lidhin këtë Kontratë Shitje (këtej e tutje referuar si "Kontrata") sipas kushteve të mëposhtme:

### Neni 1 Kushtet paraprake

Kushtet paraprake të mësipërme përbëjnë pjesë përbërëse dhe thelbësore të Kontratës.

### Neni 2 Shitja e kuotës

- 2.1. Nëpërmjet kësaj Kontrate, Shitësi shet dhe transferon kuotën që ai zotëron në kapitalin e Shoqërisë, të barabartë me 10% (dhjetë përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë (këtej



e tutje referuar si "Kuota"), të lirë nga çdo peng, privilegj, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të të tretëve, në favor të Blerësit, i cili pranon dhe e blen atë.

- 2.2. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Blerësi, në përputhje dhe në proporcion me Kuotën e blerë, merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet të saj sipas kushteve të rëna dakord, dhe në veçanti të derjtën për të marrë pjesë në fitimet e Shoqërisë duke filluar nga viti ushtrimor në vazhdim, për të ndarë pasurinë e Shoqërisë si dhe merr përsipër detyrimet dhe pasivet e mundshme.
- 2.3. Me transferimin e Kuotës sipas kësaj Kontrate, kapitali themeltar i Shoqërisë do të jetë i përbërë nga 3 (tre) kuota, të cilat do të jenë në pronësi si më poshtë:
  - **Shoqëria BLESSED INVESTMENT Sh.p.k**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar sipas legjislacionit në fuqi, me numër unik identifikimi (NIPT) L71423028S, zotëruese e 50% e kapitalit themeltar të Shoqërisë;
  - **Znj. Arta Gurabardhi**, shtetase shqiptare, e bija e Xhemilit, lindur më 20 Shtator 1977 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. personal H75920138M, zotëruese e 40% e kapitalit themeltar të Shoqërisë;
  - **Shoqëria Basha Capital Group Sh.p.k**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe organizuar sipas legjislacionit në fuqi, me numër unik identifikimi (NIPT) L41924002T, zotëruese e 10 % e kapitalit themeltar të Shoqërisë.

#### Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimi i Shitjes për blerjen e Kuotave të Shitësit nga Blerësi do të jetë përkatësish (i) 10.000 lek (dhjetë mijë lek) ("Çmimi i Shitjes") siç përcaktohet edhe në kushtet paraprake, çmim i cili është paguar nga Blerësi me nënshkrimin e kësaj kontrate.
- 3.2 Shitësi bie dakord me Çmimin e Shitjes së parashikuar sipas përcaktimeve të këtij seksioni dhe konfirmon se Blerësi nuk kanë asnje detyrim tjetër kundrejt Shitësit për Çmimin e Shitjes pasi pagesa të jetë kryer në përputhje me kushtet e mësipërme në llogarinë bankare të vënë në dispozicion nga Shitësi.
- 3.3 Të gjitha pagesat dhe detyrimet e mundshme sipas parashikimeve të kësaj Kontrate do të jenë në Lek.

#### Neni 4 Transferimi i Kuotës

- 4.1 Titulli i Kuotës do t'i transferohet Blerësit dhe Kuota do të shitet dhe do të blihet së bashku me të gjitha të drejtat, përfitimet dhe detyrimet qe i bashkangjiten Kuotës ose që rrjedhin nga ajo në Datën e Nënshkrimit (duke përfshirë të drejtën përmarrjen e të gjithë dividëntëve, shpërndarjeve apo çdo kthimi të kapitalit/investimit të regjistruar, të paguar ose të kryer në Shoqëri).
- 4.2 Palët do të nënshkruajnë dhe do të sigurojnë të gjitha dokumentet e nevojshme për regjistrimin e rregullt të transferimit të kuotës në Qendrën Kombëtare të Bisnesit.

**Neni 5**  
**Deklarime dhe Garanci të Shitësit**

- 5.1 Shiteti garanton Bleresin se eshtë personi i vetëm legjitim për të marrë përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kësaj Kontrate.
- 5.2 Shiteti garanton Bleresin se Kuota objekt i kësaj Kontrate eshtë e lirë nga çdo peng, privilegji, barrë, e drejtë parablerje apo çdo të drejtë tjetër në favor të tij tretëve.
- 5.3 Në momentin që nënshkruhet kjo kontratë, pala shitëse deklaron se nuk ka asnjë pretendim pronësie për kuotën që shet dhe asnjë formë tjetër të mundshme pretendimi nga ana e vetë shoqërisë.
- 5.4 Pala shitëse njeh të gjitha detyrimet e tillë që kanë rënduar mbi shoqërinë në tërësi dhe mban përgjegjësi mbi pasojat ligjore te administrimit të deritanishëm.
- 5.5 Bleresi deklaron se futet në Shoqëri, në përputhje dhe në proporcion me Kuotën e blerë, sipas gjendjes së faktit dhe të drejtës në të cilën ndodhet, duke deklaruar se e njeh më së miri dhe se i çliron Shitetin nga cdo lloj pasivi të Shoqërisë, si aktual ashtu dhe potencial, që ekziston deri në datën e nënshkrimit të kësaj Kontrate, në lidhje me Kuotën e Shoqërisë e cila transferohet tek Bleresi.

**Neni 6**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

- 6.1 Të gjitha mosmarrëveshjet midis Palëve që mund të lindin ose që lidhen me interpretimin, zbatimin dhe zgjidhjen e kësaj Kontrate, do të zgjidhen në përgjithësi me mirëkuptim midis Palëve me diskutim të drejtpërdrejtë midis tyre.
- 6.2 Nëse nuk arrihet që një mosmarrëveshje të zgjidhet me mirëkuptim, zgjidhja do t'i besohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**NENI 7**  
**Ligji i zbatueshëm**

Kjo Kontrate regullohet nga legjislacioni shqiptar dhe shpreh vullnetin e Palëve.

**Neni 8**  
**Përbajtja e Kontratës dhe Ndryshimet**

Kjo Kontratë përfshin tërësisht raportet ndërmjet Palëve dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme në lidhje me objektin në fjalë. Ndryshime apo shfuqizime të ndryshme mund t'i bëhen kësaj Kontrate vetëm me shkrim dhe duhet të nënshkruhen nga Palët.

**Neni 9  
Konfidencialiteti**



- 9.1 Asnjëra prej Palëve nuk duhet të zbulojë pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër tek ndonjë person, apo të bëjë një njoftim publik në lidhje me informacionet që prekin dispozitat e kësaj Kontrate dhe/ose transaksionit objekt i saj.
- 9.2 Kur njëra nga Palët vendos në mënyrë të arsyeshme se zbulimi ose njoftimi i informacionit të përmendur më sipër kërcohët në bazë të ligjit, rregulloreve ose çdo autoriteti tjetër të cilit njëra Palë i nënshkruhet, ky zbulim ose njoftim i informacionit, për aq sa lejon ligji, nëse është e mundur në mënyrë të arsyeshme, do të kryhet pas konsultimit me Palën tjetër.

**Neni 10  
Origjinalët**

Kjo kontratë është lidhur në 2 (dy) origjinalë në gjuhën shqipe.

Kjo Kontratë nënshkruhet nga Palët në Tiranë, më datë 30 tetor 2018.

\*\*\*

  
**Z. Redjan Basha**  
  
Shitësi

  
NIPT: L419240021  
**Rabie Xhuveli**  
Basha Capital Group Sh.p.k.  
Blerësi  
ALBANIA

**INTESA SANPAOLO BANK**  
Albania

290108

BASHA CAPITAL GROUP SHPK  
RRUGA THEMISTOKLI GERMENJI  
PRANI VITSH KATI 2  
TIRANE

NJOFTIM /ACKNOWLEDGMENT

TRANSFERTE / TRANSFER Transaction Date: 2018-11-02

Transfer me Llogari/ A/C TO A/C Transfer

Referencia jone/Our Reference: FJH1830607174741

Ju konfirmojme qe kemi kryer veprimin e mesqeshtem:  
We confirm that we have effected the following transaction:

Date Valuta/Value Date:	2018-11-02
Llogaria ne Debi/ DR Account No:	29010835301
Llogaria ne Kredi/ CR Account No:	91175635101
Shuma ne Debi/DR Amount:	LEK 10,000.00
Shuma ne Kredi/CR Amount:	LEK 10,000.00
Rruesi/ Rate:	1.00

Komisione/Charge      Shuma/Amount

Monedha/Currency

Kartmonedha/ Denomination	Sasia/ Quantity
5000	
2000	
1000	
500	
200	
100	
50	
20	
10	
5	

Detaje/Details: Fund Transfer from - BASHA CAPITAL GROUP SHPK C/A  
LEK 29010835301 - to - 91175635101REDJAN NYLBI BA  
SHA C/A LEK BLERJE KUOTE SIPAS KONTRATES SE SHITJE  
S

Iloj(me) sa te gjitha te dhenat dhe udhesimet per kryerjen e ketij transaksi  
e te saktia e te plota dha nan përgjegjesine time/tonen te plota,konfirmoj(me) na  
yre te parsvokuhme vlefshmerine e tyre. Nepermjet ketij dokumenti,deklaroj(me)  
dokumentet,te dhenat dha informacioni i mbledhur dhe i regjistruar nga Banka  
qe ille te identifikimit dhe verifikimit te identitetit,eshte i sakte dhe i  
ditesuar.Per cdo ndryshim ne te ardhmen ne rdonje nga te dhenat te deklaruara  
dokumentet e identifikimit te dorezuan ne Banke, une/ne kam/kemi detyrimin  
deklaroj(me) dhe dorezoj(me) ne Banke.

I declare that all information and instructions for performing this transaction are  
true and complete and under my/our fully responsibility,i/we irrevocably confirm  
its validity.By this document, i/we declare that the documents, date and any information  
selected and registered by the Bank, related to identification and my/our identity  
identification is accurate and updated.In case any change shall occur to any of the data or  
identity documents submitted in the bank, i/we must declare and provide them to the bank.

Bauer Mbiemer i Klientit

Customer's Name Surname

Firma e Klientit/Customer's Signature

Vula e Firma e Bankes  
Stamp and Bank Signature

